

PRESIDENTI I REPUBLIKËS  
Nr. 642/ Prot.  
Datë nr. 13.02.2020



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I EMËRIMEVE NË DREJTËSI

Nr. 48/ prot.  
1

Tiranë, më 12.02.2020

Lënda : Dërgohet informacion mbi procesin e konsultimit të një nisme ligjore në Kuvend

INSTITUCIONIT TË PRESIDENTIT TË REPUBLIKËS  
Sekretarit të Përgjithshëm  
Znj. Ornela Zonja

Nëpërmjet shkresës Tuaj me nr. 642 prot., datë 11.02.2020, kërkohet informacion mbi pjesëmarrjen e Këshillit të Emërimeve në Drejtësi në procesin e konsultimit të një nisme ligjore, në shqyrtim nga Kuvendi, për një projektligj të titulluar “Për disa shtesa në ligjin nr.8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese”, të ndryshuar”.

Ndërmjet të tjerave, në këtë shkresë, evidentohet se, nisur nga raporti i Komisionit për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, i publikuar në faqen zyrtare të Kuvendit, rezulton se kjo nismë është përcjellë për mendim pranë Këshillit të Emërimeve në Drejtësi.

Në vijim, në shkresën Tuaj kërkohet informacion nëse ka pasur një konsultim dhe mendim të shprehur mbi këtë nismë ligjore nga Këshilli i Emërimeve në Drejtësi, së bashku me kopjen e këtij mendimi. Për rrjedhojë, nëse është njoftuar apo jo projektligji anëtarëve të tij, është thirrur mbledhje e KED për këtë qëllim etj.

Në përgjigje të kësaj kërkesë për informacion informojmë se nuk ka pasur kërkesë nga ana e Kuvendit drejtuar Këshillit të Emërimeve në Drejtësi për të dhënë mendime mbi nismën ligjvënëse të sipërcituar. Për rrjedhojë, lidhur me këtë nismë ligjore, nuk ka ndonjë mendim të konsultuar dhe të shqyrtuar nga anëtarët e Këshillit ose mbledhja e tij apo të përcjellë Kuvendit nga Këshilli i Emërimeve në Drejtësi.

Nisur nga ardhja në dijeni, përmes shkresës Tuaj, të kësaj rrethane në përmbajtjen e Raportit të Komisionit për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, është kontaktuar menjëherë ky Komision për të marrë masat që, në lidhje me këtë aspekt, të sqarohet publikisht apo të korrigjohet dokumenti parlamentar (Raporti) i kësaj nisme ligjore.



KËSHILLI I EMËRIMEVE NË DREJTËSI 2020

Adresa Postare : GJYKATA E LARTË, Rruga Ibrahim Rugova, Ndërtesa nr. 20, Kodi Postar 1001, Tiranë, Shqipëri.  
Adresa Elektronike : Keshilli5@ked.gov.al Numra telefonikë : +355 4 2257302